

AKT-THEMELIMI

PER SHOQERINE TREGTARE

"MONTAL" Shpk



HYRJE

Ne kuptimin e ketij aktthemelimi, i cili qe ketu  
dhe me pas referohet si akt, themelues eshte :

**Skender Anton Lufi**i datelindjes 1955  
lindur ne Tirane, me banim ne Bulevardin  
"Deshmoret e Kombit", P.64, Shk.5, Ap.37  
Tirane, me kombesi dhe shtetesi shqiptare.

2. OBJEKTI

Si objekt i ketij akti eshte themelimi nga  
themeluesi me cilesine e ortakut te vetem te  
shoquerise tregtare me perjegjesi te kufizuar :  
**"MONTAL" Shpk.**

3. KAPITALI THEMELTAR

Shoqueria do te kete nje kapital themeltar prej  
100 000 lekesh.

4. ADMINISTRIMI

Shoqueria do te drejtohet nga administratori i saj,  
i cili do te veproje ne baze te statutit te  
shoquerise.

5. VEPRIMTARIA E SHOQUERISE

Shoqueria do te zhvilloje veprimtari ne fushat e  
percaktuara ne statutin e saj.

6.

## KOHEZGJATJA E SHOQUERISE

Shoqeria themelohet per nje periudhe mbi dhjete vjet. Ajo mund ta mbaroje aktivitetin e saj edhe me pare, ne perputhje me normat e statutit te saj dhe te legjisacionit ne fuqi.

7.

## SELIA

Shoqeria do ta kete seline e saj ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit", Pall. 64, Shk. 5, Ap. 37, Tirane.

Tirane, me 13. 12. 1995.

THEMELUESI

SKENDER LUFİ

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7411 Rep.  
Nr. 2635 Kol.

Tirane, me 13. 12. 95.

## V E R T E T I M

Vertetohet se sot u paraqit ne zyren e noterise i quajturi:  
**Skender Anton Lufi**, i datelindjes 1955, lindur dhe banues ne Tirane, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

I lartepermenduri, per identitetin e te cilit u sigurova nepermjet leternjoftimit qe me paraqiti, nenshkroi para meje me vullnet te lire dhe ne menyre te rregullt dokumentin e lartepermendor.



**NOTERE**



# STATUTI

I SHOQERISE TREGTARE

## "MONTAL" Shpk

### 1. HYRJE

- 1.1 Shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar "MONTAL" Shpk e cila qe ketu dhe me pas referohet si shoqeri krijohet mbi bazen e iniciatives dhe kapitalit themeltar te ortakut te vetem:

**Skender Anton Lufi**, i datelindjes 1955, lindur ne Tirane, me banim ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit" P.64, Shk. 5, Ap. 37 Tirane, me kombesi dhe shtetesи shqiptare.

- 1.2 Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat e ketij statuti, si dhe te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.
- 1.3 Kjo shoqeri si shoqeri me perjegjesi te kufizuar i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

### 2. OBJEKTI:

Objekt i veprimtarise se shoqerise do te jete :

- 2.1 Veprimtaria Projektuese ne te cilin perfshihen :

- 2.1.1 Projektimi i strukturave te zakonshme metalike
- 2.1.2 Projektimi i strukturave te veshtiresise se larte metalike.
- 2.1.3 Projektimi termoteknik, ventilimi, kondicionim ajri etj.
- 2.1.4 Projektimi i sistemeve te furnizimit me gaz.



2.1.5 Projektimi i makinerive te ndertimit si vinça, mekanizma ngritese, ashensore, transportiere, netoniera e te tjetra te ketij karakteri.

2.1.6 Projektimi i konstruksioneve metalike te shkalles se larte te veshtiresise si porta, segmente te rrafshta etj te ketij karakteri.

2.2 Veprimitaria zbatuese ne te cilen perfshihen :



2.2.1 Prodhime druri, metalike, plastike per dyer, dritare, kallepe, e te tjere,

2.2.2 Ndertime civile dhe ekonomike ( per punimet e montimit ).

2.2.3 Ndertim ujesjellesa dhe kanalizime.

2.2.4 Ndertim impiantesh te trajtimit te ujit.

2.2.5 Ndertim gazsjellesa, vajsjellesa dhe te tjere te ketij karakteri.

2.2.6 Sillosa, kulla, kulla uji, etj metalike.

2.2.7 Punime karpentierie metalike.

2.2.8 Montimi dhe instalimi i makinerive dhe impianteve ngritese dhe transportuese.

2.2.9 Montimi dhe instalimi i impianteve termike, te ventilimit, te kondicionimit dhe mirembajtja e tyre.

2.2.10 Montimi dhe instalimi i impianteve hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre.

2.2.11 Punime bojatisje, hidroizoluese, termoizolimi, akustie dhe kundrazjarrit te impianteve teknologjike.

2.2.12 Montimi dhe instalimi i impianteve gazit dhe i eneve me presion si dhe mirembajtja e tyre.

2.2.13 Montimi centraleve hidraulike, centraeleve termike, impianteve per prodhimin e energjisë alternative.

2.2.14 Punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal dhe punime per mirembajtjen e tyre.

2.3 Import eksporti dhe tregtimi me shumice e pakice i te gjithe llojeve te mallrave.

3. EMRI, SELIA, TERITORI

3.1 Kjo shoqeri do te quhet "MONTAL" Shpk. Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.



3.2 Shoqeria do ta kete qendren e saj ne qytetin e Tiranes, ku do te zhvillohet aktiviteti i saj kryesor ekonomik. Selia e shoqerise do te jete ne Bulevardin "Deshmoret e Kombit" P. 64, Shk.5, Ap.37 Tirane.

3.3 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

3.4 Ajo mund te krijoje dege ose perfaqesi ne rrethe te ndryshme te Shqiperise si dhe jashte saj.

4. KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE :

4.1 Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributti i ortakut te vetem ne shumen prej 100 000 leke.

4.2 Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje banke te qytetit te Tiranes, para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

4.3 Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet ne varesi te rezultateve dhe ne perputhje me normat e legjisacionit ne fuqi.

4.4 Kapitali themeltar mund te shtohet edhe nepermjet pranimit te ortakeve te tjere.

4.5 Kapitali themeltar mund te transferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

*Suef -*

- 4.6 Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortak, nepermjet transferimit te pjesave te kapitalit, me vendim te ortakut te vetem dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligj.
- 4.7 Shoqeria mund te kete dhe kontribute ne natyre. Ne kontribute ne natyre perfshihen te gjithe sendet e e paluejtshme si dhe makinerite e pajisjet e ndryshme qe vijnë ose kalojnë ne pronesi te shoqerise.

5. FONDET E SHOQERISE

5.1 Shoqeria percakton fonde e me poshtme :

1. Fondin themeltar ( qarkullues ).
2. Fondin rezerve.
3. Fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj

5.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij, percaktohet me vendim te organit drejtues te shoqerise.

6. ORGANI DREJTUES DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 6.1 Per sa kohe qe shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, si organ drejtues i saj do te jetet ortaku i vetem qe njekohesishet eshte dhe administrator i saj.
- 6.2 E gjithe veprimtaria e shoqerise percaktohet nga administratori i saj ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.
- 6.3 Per administrimin e shoqerise ose te aktivitetave te vecanta te saj, administratori kryesor, mund te emeroje nje ose disa administratore te tjere.

*Siguri -*

- 6.4 Kompetencat e administratoreve te tjere te mundshem percaktohen ne aktin e emerimit te tyre.
- 6.5 Shoqeria nuk merr persiper veprimet e ndryshme qe mund te kryejne administratorret e tjere te mundshem ne marredhenie me te tretet, te cilat i tejkalojne kompetencat e tyre te percaktuara ne aktin e emerimit.



Administratori, per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara, si dhe menyren e mbajtjes se regjistrave te veprimeve kontabile, emeron nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per nje periudhe prej gjashte vitesh financiare. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara ne ligj.

## 7. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Per sa kohe qe shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, kompetencat e administratorit te saj do te jene :

- 7.1 Vendos per ndryshimet ne statutin e shoqerise dhe miraton rregulloret per sektoret e vecante te saj.
- 7.2 Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- 7.3 Emeron dhe shkarkon administratorret e tjere te mundshem dhe percakton kompetencat e tyre ne aktin e emerimit.
- 7.4 Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve te ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- 7.5 Vendos per krijimin e degeve ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive te perbashketa.
- 7.6 Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e shoqerise, nese ne dokumentet financiare, rezultatet e shoqerise vleresoohen me humbje.

*Suefi —*

- 7.7 Vendos per shnderrimin e shoqerise nga SHPK ne shoqerite llojeve te tjera.
- 7.8 Realizon marredheniet me te rendesishme financiare dhe ekonomike te shoqerise me persona te tjere fizike ose juridike.
- 7.9 Realizon ose miraton cmimet e shitjes dhe te sherbimeve.
- 7.10 Vendos per pagat e personelit te shoqerise.
- 7.11 Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet e ndryshme shteterore dhe me personat e tjere fizike dhe juridike.

8. MENYRA E PERFAQESIMIT

- 8.1 Shoqeria perfaqesohet nga administratori i saj, ne te gjithe marredheniet juridike civile me persona te tjere fizike dhe juridike si dhe ne organet e ndryshme shteterore.
- 8.2 Ajo mund te perfaqesohet edhe nga ndonje person tjetër, i autorizuar prej administratorit te saj, me prokure te posacme ose autorizim te vecante.

9. FITIMI

- 9.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme pagave, te punonjesve etj. ortakut te vetem i mbetet ne dispozicion fitimi neto.
- 9.2 Fitimi neto mund te transferohet jashte Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 9.3 Fitimi mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltar, per zgjerimin e tij me kontribute ne natyre, per shtimin e fondeve te shoqerise si dhe per qellime te tjera qe nuk vijnë ne kundershtim me ligjin.

*Suek —*

10. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria krijohet per nje periudhe mbi 10 vjet.

11. MAREDHENIET E PUNESIMIT

Cdo person, duke perfshire dhe administratoret e tjere te mundshem, do te punesohen ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes, te lidhur ndermjet tij dhe administratorit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

12. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE

Cdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushe detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes, nga vendimet e administratorit, si dhe nga statuti i shoqerise. Per shkelje te natyres se mesiperme, si dhe per shkelje te legjislacionit ne fuqi, prej te cilave shoqerise mund t'i shkaktohen deme, ndaj secilit prej tyre mund te merren masa te ndryshme deri ne largimin nga puna, ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

13. KONFIDENCIALITETI

- 13.1 Te gjithe personat qe do te punesohen ne shoqeri jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, te njojurive dhe pervojes se shkembyer si dhe te cdo lloj materiali tjeter konfidential dhe duhet te adaptojte te gjithe masat e nevojshme per te parandaluar perhapjen e tyre qofte dhe pjeserisht.
- 13.2 Masat e parashikuara ne nenin 12 mund te merren dhe ndaj atyre qe kryejne mosrespektimin e konfidentialitetit te parashikuar ne paragrafin (13.1).

*Suefi -*

14. MBARIMI I SHOQERISE

- 14.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues, ne rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurese si dhe per shkaqe te tjera te parashikuara ne ligj.
- 14.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te thithjes dhe te bashkimit.
- 14.3 Gjate fazeve se likuidimit, pergjegjesia e administratorit dhe e likuidatorit eshte e njezte.

15. DISPOZITA TE FUNDIT

- 15.1 Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.
- 15.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne ndonje institut sigurimi.
- 15.3 Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles, percaktohen nga administratori kryesor.

Statuti i shoqerise u miratua nga ortaku i vetem dhe administratori i saj, sot me date \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.

ORTAKU I VETEM DHE  
ADMINISTRATOR

SKENDER LUPI

